



ALTERNATIVA

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informata të përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9 - 14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Subjektit Politik Alternativa

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik “Alternativa” (në vijim referuar si “Subjekti Politik”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2021, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë date, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq 6-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2021, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për periudhën, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion te kualifikuar

- Siç është prezantuar në Shënimin 6 Llogaritë e arkëtueshme, në vlerë prej 28,853.84 EUR (31 Dhjetor 2020: 28,853.84 euro), në mungesë të konfirmimit nga palët e treta dhe në mungesë të dokumenteve tjera mbështetëse, ne nuk ishim në gjendje duke përdorur procedurat standarde dhe alternative të auditimit të marrim siguri të arsyeshme në lidhje me tërësinë, ekzistencën dhe saktësinë e Llogarive të arkëtueshme në vlerë 28,853.84 EUR në datën e raportimit.
- Pasqyrat financiare për fund vitin 2020 nuk janë audituar. Ne nuk jemi në gjendje për të përcaktuar ndikimin e ndonjë ndryshim që mund të jenë të nevojshme për pasqyrat financiare të fund vitit më 31 Dhjetor 2021.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- SP nuk ka mbajtur kontabilitet të dyfishtë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikuara në Kosovë. siç parashikohet me ligjin nr. 04/L-212 për ndryshime në Ligjin nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 15 i Raportimit Financiar.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t’u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Elmije Osmani Shatri
Auditor Ligjor
18 Tetor 2023

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2021	Me 31 Dhjetor 2017
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5		
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		28,853.84	28,853.84
Parapagimet		0.00	0.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	486.85	316.75
Pasuritë tjera afatshkurtra		0.00	0.00
Total pasuritë afatshkurtra		29,340.69	29,170.59
Total pasuritë		29,340.69	29,170.59
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		27,721.58	26,679.86
Suficiti / (deficiti) i vitit		1,619.11	1,041.72
Total Ekuiteti		29,340.69	27,721.58
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	5		
Gjithsej detyrimet afatgjata			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		26,679.86
Huatë e pagueshme			1,041.72
Detyrimet tjera afatshkurtra	9		
Gjithsej detyrimet afatshkurtra			27,721.58
Gjithsej detyrimet			27,721.58
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		29,340.69	29,170.59

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2021	2017
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		0.00	0.00
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	0.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	9,800.00	14,058.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00	0.00
Të hyrat e fushatës		0.00	0.00
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera	5	0.00	0.00
Të hyrat tjera		0.00	0.00
Gjithsej të hyrat për vitin		9,800.00	14,058.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit	2	0.00	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	1,168.38	0.00
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	0.00
Blerja e mallrave	2	553.26	37.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	5,777.29	11,819.28
Shpenzimet e ndryshme	2	681.96	1,160.00
Gjithsej shpenzimet për vitin		8,180.89	13,016.28
Suficiti / (deficiti) për vitin		1,619.11	1,041.72

1. Informata te përgjithshme

Subjekti Politik “Alternativa“

Subjekti Politik “Alternativa“ është themeluar më datën 24.07.2017

Kryetari i Subjekti Politik “Alternativa“ për vitin 2021 është : z. Mimoza Kusari

Zyrtar financiar: Liridon Derguti

Pasqyrat financiare te Subjekti Politik “Alternativa“ janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën Bankën Ekonomike

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	0.00	0.00	0.00
Tatimet në të ardhura personale	0.00	0.00	0.00
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	0.00	0.00	0.00
Karburantet	0.00	0.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	0.00	0.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	0.00	0.00	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	0.00	0.00	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	68.38	68.38	0.00
Ushqimi			0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	1,100.00	1,100.00	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	1,168.38	1,100.00	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00

“Alternativa“

Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor, 2021

Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	345.64	345.64	0.00
Pajisjet të vogla	207.62	207.62	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	553.26	553.26	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	5,219.80	5,219.80	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	127.05	127.05	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	430.44	430.44	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	5,777.29	5,777.29	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	156.96	156.96	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	525.00	525.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	681.96	681.96	0.00
Gjithsej shpenzimet			
Gjithsej shpenzimet	8,180.89	8,112.51	0.00

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
ARGJEND SHALA	GJAKOVË		15.01.2021	300.00	300.00	
LIRIM BICURRI	GJAKOVË		21.01.2021	150.00	150.00	
ARGJEND SHALA	GJAKOVË		21.01.2021	500.00	500.00	
MIMOZA KUSARI	PRISHTINE		22.01.2021	1,000.00	1,000.00	
MIMOZA KUSARI	PRISHTINE		26.01.2021	850.00	850.00	
KALTRINA BIBLEKAJ	GJAKOVË		01.02.2021	50.00	50.00	
ARGJEND SHALA	GJAKOVË		01.02.2021	500.00	500.00	
LULZIME SARAQINI	PRISHTINE		05.02.2021	2,000.00	2,000.00	
SHKUMBIN SPAHIJA	PRISHTINE		05.02.2021	2,000.00	2,000.00	
ARBEN LILA	PRISHTINE		05.02.2021	2,000.00	2,000.00	
DIANA QARKAXHIJA	PRISHTINE		13.02.2021	200.00	200.00	
ARGJEND SHALA	GJAKOVË		16.02.2021	250.00	250.00	
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				9,800.00	9,800.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka	0.00		//////////		0.00
Objektet	0.00				0.00
Veturat	0.00				0.00
Pajisjet e zyrës	0.00				0.00
Pajisjet e teknologjisë informative	0.00				0.00
Pajisjet tjera	0.00				0.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	0.00				0.00

Shenime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro
Llogari te arketueshme	28,853.84	28,853.84
..... blerësi 2		
..... blerësi 3		
Llogari të arkëtueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	28,853.84	28,853.84

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro
Paraja në bankë	186.85	316.75
Paraja në arkë	300.00	0.00
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	486.85	316.75

“Alternativa“

Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor, 2021

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro
..... furnitori 1		
..... furnitori 2		
..... furnitori 3		
..... furnitori 4		
Llogari të pagueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	0.00	0.00
Detyrimet për qira	0.00	249.01
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	0.00	0.00
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	0.00	1,200.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	0.00	1,449.01

“Alternativa“

Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor, 2021

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		në euro
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					0.00